

AKT THEMELIMI

Sot ne dt.26 Janar 2020 me cilesine e "Ortakut te Vetem Themelues ",

GLIGOR ZHUPAJ, i biri i Llambro(s), i datelindjes 01/07/1946, i lindur ne Vanë Sarande dhe banues ne fshatin Borsh Sarande, lagjia Vonja, shtetas shqiptar, madhor me zotesi juridike dhe per të vepruar, identifikuar sipas ligjit nepermjet Leternjoftimit nr. 035392095 ,leshuar nga MB me date 27/12/2019,i cili me vullnet të lire të plote e të sinqerte, dhe iniciativen e lire private, mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin 9901 date 14.04.2008, " Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", ne ligjin "Per Qendren Kombetare te Biznesit", ne Kodin Doganor, Fiskal e Tëtimor, krijon shoqerine tregtare, me perqegjesi të kufizuar, me emertimin **MALG** shpk.

KREU I

Emertimi, Forma Juridike, Selia, Kohezgjatja, Objekti

Neni 1

Emertimi

Emërtimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është **MALG** shpk. Shoqeria do ti nenshtrohet legjislacionit Shqiptar. Shoqeria do te ushtroje veprimtarine e saj ne baze te ketij akti themelues dhe statutit te shoqerise qe do te miratohet nga ortaku themelues.

Neni 2

Forma Juridike

Shoqeria **MALG** shpk, eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me perqegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur "Shoqeria").

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendren Kombetare te Biznesit, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqeria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

Shoqëria **MALG** shpk, eshte nje e tille, kapitali i së cilës ndahet në kuota dhe që themelohet nga ortaku i vetem që përballon humbje vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tij në kapitalin themeltar.

Neni 3

Selia

Shoqeria e ka seline ne adresen:

Lagj. Vonja,Borsh,Bashkia Himare, pasuria nr.181/14,zk 1253, Shqiperi.
Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijoje filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetëm me Vendim te Asamblese se Ortakut te vetem.

Neni 4

Objekti i veprimtarise

- Investime dhe sherbime ne fushen e hotelerise,Bar-Restorant-Plazh,sherbime turistike,operator turistik,agjensi turistike,agjensi udhetimesh turistike,marrje dhe dhenie me qira hotele dhe dhoma per qellime turistike,dhenie me qera e automjeteve dhe çdo sherbim tjeter ne fushen e turizmit.
- Ndertime te objekteve civile dhe industriale.Projektimi dhe zbatimi per ndertimin e objekteve te ndryshme si dhe te ndertimeve civile industriale, turistike,bujqesore dhe kompletimi me instalime te nevojshme me tuba betoni si dhe ata elektrike, hidraulike, sistemeve te ngrohjes, ujsjellesa, kanalizime,hapje trasesh te te gjitha llojeve fushen e ndertimit, ndertim rrugesh,asfaltime etj. Sherbime te te gjitha llojeve ne fushen e ndertimit.Prodhim i materialeve te ndryshme betoni.



- **Perfaqesime kompanish te ndryshme nderkombetare, eskluzivitete apo ndermjetesime kompanish nderkombetare, ne fusha te prodhimit, tregtimit apo sherbimeve te ndryshme.**
- **Sherbime konsulence per investitorret, planifikasi, projektim dhe realizim i projekteve Industriale, Energjite, Turistike e Bujqesore.**

Neni 5
Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore te papercaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit (QKB).

KREU II

KAPITALI

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 10,000,000 lekë.

Kapitali i shoqerise eshte 10.000.000 leke i perbere nga 1 kuote dhe zoterohet nga ortaku i vetem i shoqerise. Z. **GLIGOR ZHUPAJ**

Vlera totale e Kapitalit te Regjistruar eshte **10.000.000 Leke**

Vlera Totale e Kapitalit prej **10.000.000 Leke** do te paguhet ne te ardhmen nga ortaku themelues.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme dhe as me kontribute në shërbime.

Ortaku i vetem themelues per gjigjet per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tij ne kapitalin themeltar te shoqerise;

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Pjesët e kapitalit themeltar mund tu transferohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri, vetëm me Vendim te Asamblese se Ortakut te vetem.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie. Ato janë lirisht të transferueshme edhe në rast ndarjeje pasurore mes bashkëshortëve. Gjithashtu janë të transferueshme ndërmjet bashkëshortëve, si dhe ndërmjet paraardhësve dhe pasardhësve.

KREU II

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organ i Vendimmarres

Asambleja e Ortakut te vetem themelues eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e Ortakut te vetem eshte organi vendimmarres i shoqerise qe mìraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e Ortakut te vetem brenda një afati prej gjashtë muajsh, duke filluar nga data e mbylljes së vitit finanziar, mìraton raportin e administrimit, inventarin, bilancin dhe llogaritë vjetore, të hartuara nga administratori.

Neni 9

Administrimi

Shoqeria do te administrohet nga nje administrator i vetem.

Administrator i shoqerise eshte emeruar **GLIGOR ZHUPAJ**, i biri i Llambro(s), i datelindjes 01/07/1946, i lindur ne Vanë Sarande dhe banues ne fshatin Borsh Sarande, lagjia Vonja, shtetas shqiptar, madhor me zotesi juridike dhe per të vepruar, identifikuar sipas ligjit nepermjet Leternjoftimit nr. 035392095 ,leshuar nga MB me date 27/12/2019. Emerimi i administratorit eshte me nje afat pese vjeçar me te drejte riemerimi, i cili ka te gjitha kompetencat per te kryer te gjitha veprimet e themelimit te

shoqerise te parashikuara nga legjislacioni ne fuqi.
Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim te Asamblese se ortakut te vetem te shoqerise.

Neni 10
Kompetencat

Administratori ka te gjitha kompetencat per te vepruar ne marrëdhënie me te tretët ne emer te shoqërisë, ne te gjitha rr Ethanat me përashtim te kompetencave qe ligji ia jep shprehimisht Asamblese se ortakeve te shoqerise.

Administratori angazhon shoqerinë ne marrëdhëniet me te tretët nepërmjet akteve qe janë ne përputhje me objektin e saj.

Shoqeria nuk merr përsipër pasojat ndaj te tretëve kur ajo provon se te tretët e dinin qe akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur te tretët nuk mund ta injonon këte akt ne rr Ethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Klauzolat e ketij statuti qe kufizojnë kompetencat e administratorit, te cilat rrjedhin nga ky nen, duhet te respektohen nga te tretët.

Administratori ose ortaku qe nuk janë persona juridikë nuk u lejohet te kontraktojnë ne çfarëdolloj forme qoftë, te marrin hua te shoqeria, te jasin pëlqimin ne emer te saj, per paradhënie si dhe te bëhen dorëzenës apo te garantojnë ne emer te saj angazhimet ndaj te tretëve. Ne rast te kundërt kontrata është e pavlefshme.

Neni 11
Viti Financiar

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor.

Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Regjistrin Tregtar Shqiptar dhe mbyllt me 31 Dhjetor.

Neni 12

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe dhe per çfaredo shkaku, edhe para plotesimit te afatit per te cilin eshte krijuar sic mund te jene

a.Humbja e kapitalit ose pamundesia e vazhdimit te metejshem te veprimtarise se saj.

b.Ne nga menyrat e parashikuara nga ligji "Per Falimentimin"

c.Kur plotesohet afati i caktuar per ushtrimin e veprimtarise tregtare.

Ne kete rast Asambleja e Ortakut te vetem merr vendim me shkrim ne te cilin parashikon menyeren e likuidimit te shoqerise, duke caktuar nje apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument te nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese " Shoqeri ne likuidim e siper ".

Neni 13
Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne përputhje te plete me kete akt themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete akt themelimi, do te zbatohen dispozitat e ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil , Ligji per QKB, dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 14

Dispozita perfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua ne tre ekzemclare me permabjtje dhe vlera te njejtë juridike, ne gjuhen shqipe dhe pasi miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaku i vetem themelues i shoqerise tregtare **MALG** shpk, nenshkruehet ne te gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen e tij orgjinale.

ORTAKU I VETËM I SHOQËRISE

Gjigor Zhefaj
Celil